

SFIDAT EKONOMIKE NË LUGINËN E PRESHEVËS

FIDAN KOSUMI *

(Abstrakt) Ky punim synon të hedhë dritë mbi çështjen e situatës ekonomike në Luginën e Preshevës, çështje kjo që mbizotëron viteve të fundit, pasojat e së cilës sot përkrahin tërë Evropën Perëndimore. Pas zhvillimeve të vitit 1999 e deri më sot, Lugina e Preshevës është përballur me shumë sfida të përsëritura të natyrës politike dhe ekonomike. Si rezultat i rrethanave të krijuara, pakënaqësia e popullsisë me situatën ekonomike dhe politike është rritur dhe viteve të fundit ka nxitur një migrim masiv të njerëzve që kërkojnë një jetë më të mirë në vendet më të zhvilluara, e që zakonisht janë vendet e Evropës Perëndimore. Ky trend vazhdon edhe sot, përkundër ndryshimeve të vërejtura në sferën ekonomike dhe politike në Serbi. Pavarësisht nga këmbëngulja, ky problem gjatë gjithë kohës ka mbijetuar nën hije, ndërsa efektet e tij negativë vazhdojnë të paraqiten në sipërfaqe. Si pasojë e kësaj situatë, Republika e Serbisë dhe Bashkimi Evropian aktualisht po përballen me efektet e këtij problemi, siç është për shembull çështja e azilkërkuësve nga ky rajon, ndërsa shkaqet vazhdojnë të mbeten këtu, në Luginën e pazhvilluar të Preshevës duke pritur me shpresë se do të trajtohet në të ardhmen e afërt.

Fjalët kyçe: Serbia, Lugina e Preshevës, gjendja ekonomike, papunësia, migrimi, zgjidhjet e mundshme, zhvillimi ekonomik

*

Hyrje

Lugina e Preshevës, në gjuhën shqipe është emërtim i përbashkët për tre komunat: Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, e banuar me popullatë të përzier, kryesisht shqiptare dhe serbe.¹ Sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë të vitit 2002, Lugina e Preshevës ka 88,966 banorë, prej të cilëve 57,595 janë shqiptarë.² Regjistrimi i fundit zyrtar është mbajtur në vitin 2011, por për shkak të pakënaqësisë së shqiptarëve me situatën politike dhe ekonomike dhe për shkak të çështjes alarmuese të migrimit të popullsisë nga Lugina e Preshevës në 10 vitet e fundit, shqiptarët kryesisht kanë bojkotuar regjistrimin e popullsisë.

Ndonëse rajoni është i pasur me burime natyrore dhe ka një pozicion strategjik gjeografik, i pozicionuar afër Rrugës Evropiane E75, si pjesë e korridorit pan-evropian X, ai vazhdon të përballlet me probleme të shumta të natyrës ekonomike.

Gjatë dy viteve të fundit pavarësisht përpjekjeve të ndryshme nga ana e pushtetit qendror, pushtetit lokal si dhe organizatave ndërkombëtare për përmirësimin e situatës ekonomike në Luginën e Preshevës, niveli i dëshirueshëm i zhvillimit ekonomik është ende larg arritjes. Një prej zgjidhjeve të ofruara nga shteti ka qenë krijimi i Trupit Koordinues të Qeverisë së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë më 16 dhjetor të vitit 2000. Krijimi i këtij Trupi Koordinues në politikën e qeverisë serbe shënoi një qasje të re për zgjidhjen e tensioneve ekzistuese etnike në rajon. Fushat prioritare të veprimit të Trupit Koordinues në tre komunat janë: arsimi, çështjet sociale, zhvillimi ekonomik dhe forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile.³

* Autori: Fidan Kosumi, ka fituar titullin MBA (Magjistër i Administrimit të Biznesit) në Universitetin e Evropës Juglindore, në Fakultetin për Ekonomi dhe Biznes, në Tetovë, Maqedoni.

¹ Në gjuhën shqipe/Në gjuhën serbe: Preshevë/Preševo, Bujanovc/Bujanovac dhe Medvegjë/Medvedja

² Republic of Serbia, Republic Institute for Statistics, Publication: Final census results, no. 295, LII, 24.12.2002. <http://www.mtt.org.rs/Srbijapopis2002.pdf>


³ Qeveria e Serbisë, Trupi Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë <http://www.kt.gov.rs/en/articles/about-us/>

Pavarësisht nga të gjitha, për shkak të disa rezultateve të dobëta, situata aktuale ndoshta kërkon një ndryshim më të kujdesshëm të politikës në strategjitë dhe menaxhimin e këtij rajoni. "Për menaxherët bota ndryshon. Ajo ndryshon nga ora në orë, nga dita në ditë dhe nga java në javë. Strategjitë që ishin efektive dje nuk janë domosdoshmërisht efektive në të njëjtën situatë sot".⁴

Problemet aktuale ekonomike në Luginën e Preshevës

Norma shumë e lartë e papunësisë vazhdon të mbetet një nga problemet më të rëndësishme të Luginës së Preshevës. Sipas analizës së Ministrisë për Zhvillim Regjional dhe Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Serbisë "Serbia Jugore - pjesa më e varfër", norma e papunësisë në komunën e Preshevës dhe komunën e Medvegjës është mbi 50%. Norma e papunësisë në komunën e Bujanovcit sillet rreth 50%.

Grafiku 1: Komunitat në vitin 2012 me shkallën e papunësisë më të lartë se 50%.⁵



Sipas kësaj analize, periudha e tranzicionit ka shënuar rënie të madhe të punësimit në të gjitha rajonet, por në jug të Serbisë kjo rënie ka qenë shumë më e lartë sesa mesatarja në nivel shtetëror. Ndërsa në Serbi në vitin 2001 çdo punëtor i katërt ka mbetur pa punë, në jug të Serbisë, në të njëjtën periudhë çdo punëtor i dytë ka mbetur pa punë.

Për shkak të normës së lartë të papunësisë, popullata në këtë rajon po përballet me problemin e një standardi shumë të dobët të jetesës. Fuqia blerëse mbetet e dobët ndërkohë që kërkesa sillet kryesisht rreth produkteve dhe shërbimeve më themelore. Me karakteristika të tilla, tregu, në mënyrë individuale në secilën komunë, mund të konsiderohet si relativisht i vogël dhe mjaft i dobët për vetëzhvillim. Një treg i tillë nuk është atraktiv për ndërmarrësit potencialë, ndërsa pamundësia për të mbijetuar në një treg të hapur dhe për t'i bërë ballë konkurrencës është një tjetër fakt shqetësues dhe i dëmshëm për sektorin privat.

Megjithëse vendi vazhdon të pësojë procesin e tranzicionit, sektori privat ende nuk ka fituar vendin që meriton. Ai mbetet i plogësht dhe si i tillë nuk i shërben qëllimit të tij kryesor.

Viteve të fundit, kriza globale ekonomike ka dobësuar edhe më tej standardin tashmë të dobët të popullatës së këtij rajoni. Duke pasur parasysh se shumë familje të Luginës së Preshevës jetojnë nga remitancat, dobësimi i standardit ekonomik të anëtarëve të familjeve që punojnë jashtë vendit drejtpërdrejtë ka ndikuar në standardin e atyre që varen nga remitancat.

Problemet ekonomike në këtë rajon padyshim se kanë ndikuar në fushën sociale apo demografike, duke rezultuar me zhvendosje mjaft masive të popullsisë, që u bë një nga problemet më të mëdha që sot preokupon autoritetet lokale dhe ato qendrore.

⁴ Cituar: Robert Quinn (2002), Management extra - Leadership and management in organizations, Elsevier Linacre House, First edition 2007, faqe 3.

⁵ "Serbia jugore – pjesa më e varfër" – Analizë e Ministrisë së Zhvillimit Regjional dhe Pushtetit Lokal të Republikës së Serbisë, mars 2013.

Cilat janë zgjidhjet e mundshme?

Për banorët lokalë në Luginën e Preshevës, sektori publik, si: komunat, policia, institucionet shëndetësore, mbeten vendet më tërheqëse për punësim. Megjithatë, kjo nuk mund të shihet si një zgjidhje afatgjatë për papunësinë e lartë të tanishme të popullatës së re, ose si një mënyrë për të parandaluar emigracionin e mëtejshëm. Për shkak të dobësive të shumta të sektorit privat, tendenca e të gjithë të papunëve është të kërkojnë punë në sektorin publik.

Gjithashtu, hapja e fakulteteve, sidomos atyre ekonomike mund të konsiderohet si një nga përpjekjet për të zbutur gjendjen aktuale. Njohuritë fundamentale të të diplomuarve me siguri se do të jenë të dobishme, por në mënyrë që të arrihen rezultate më të prekshme, përpjekjet duhet të orientohen drejt mbështetjes së frymës sipërmarrëse me njohuri profesionale, përkatësisht iniciativave të ndikimit të shpejtë dhe programeve speciale.

Për të siguruar një mënyrë më efektive dhe efikase të zgjidhjes së problemeve ekonomike, një qasje e re strategjike për të investuar në këtë rajon është e nevojshme. Në këtë kuptim, qeveria qendrore dhe komunat mbi të gjitha duhet të fokusohen në identifikimin e fushave problematike ekzistuese dhe të punojnë së bashku për forcimin e sektorit privat. Qeveria dhe komunat duhet të bëjnë përpjekje për të siguruar një mjedis sa më të përshtatshëm dhe më të qëndrueshëm për biznesin. Së pari, të investojnë në ndërtimin e infrastrukturës adekuate, të mbështesin të gjitha format e edukimit të sipërmarrësve potencialë në të ardhmen, të sigurojnë fonde të mjaftueshme, stimulime financiare dhe fiskale për sipërmarrësit potencialë, të punojnë shumë për të tërhequr investitorë të huaj dhe të promovojnë rajonin jashtë shtetit. Vëmendje të veçantë duhet kushtuar identifikimit të potencialeve strategjike për zhvillim ekonomik dhe ofrimit të partneritetit të mirëfilltë sektorit privat. Përveç mbështetjes ekonomike, autoritetet duhet të sigurojnë zbatimin e kornizës ligjore dhe të sigurojnë respektimin e të drejtave të punëtorëve sepse ka tendencë që ato të jenë të shtypura apo të mos respektohen nga pronarët e bizneseve.

Fatkeqësisht, mjedisi i biznesit në këtë rajon vazhdon të mbetet i pafavorshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në këtë kuptim të gjitha përpjekjet duhet të mobilizohen për të mbështetur projekte të mëdha në përputhje me prioritetet dhe burimet e çdo komune të tilla si, për shembull: përdorimi i pozitës së mirë gjeografike, burimeve të arsimuara njerëzore, burimeve natyrore, minierave apo ujërave termale dhe minerale. Në ditët e sotme, projektet potenciale të mëdha në fushën e bujqësisë, blegtorisë, minierave, hotelarisë dhe turizmit duket se janë e vetmja rrugë përpara drejt ofrimit të zgjidhjeve të qëndrueshme për situatën e tanishme.

Zhvillimi ekonomik i Luginës së Preshevës duhet të jetë një aktivitet i organizuar i autoriteteve lokale në bashkëpunim me autoritetet kombëtare dhe të gjitha palët e interesuara (*stakeholders*) në drejtim të krijimit të një klime më të mirë për biznesin. Është e domosdoshme të sigurohet një klimë e favorshme biznesi për krijimin dhe rritjen e ndërmarrjeve private dhe rritjen e punësimit. Për këtë qëllim do të ishte e dëshirueshme të krijohen fonde të veçanta. Me qëllim që të realizohen efekte sa më të mëdha do të ishte e dëshirueshme që të ekzistojë një vizion dhe strategji e shkruar për zhvillim ekonomik të Luginës së Preshevës. Arsyeya për një deklaratë me shkrim të vizionit dhe strategjisë është përqëndrimi më i mirë në probleme, lehtësimi i komunikimit dhe monitorimi i zbatimit të tyre.

Së fundi, faktorët politikë nuk duhet lënë anash në këtë proces. Me rëndësi shumë të madhe në këtë drejtim është gjetja e një zgjidhje të shpejtë dhe të mirë për të lejuar lëvizjen e lirë të mallrave me Kosovën gjë që mund të hapë rrugën për gjenerimin e ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme në komunat e Luginës së Preshevës. Komunat duhet të angazhohen fuqishëm dhe të tregojnë një vullnet të fortë për të bërë progres pozitiv në fushën ekonomike, por që të jenë të suksesshme në këtë aspekt ato duhet të bëjnë një rishikim të plotë të politikave dhe rezultateve ekzistuese në mënyrë që të sigurohet një qasje produktive strategjike në vitet në vijim.

Konkluzioni

Problemet ekonomike të Luginës së Preshevës sigurisht se kërkojnë një qasje të re strategjike dhe qasje tejet serioze multilaterale. Para së gjithash, duhet pasur parasysh se stabiliteti politik dhe ekonomik janë parakusht për zhvillimin e këtij rajoni. Objektiv kryesor i të gjitha aktiviteteve që do të ndërmerren duhet të jetë përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve. Në këtë drejtim autoritetet duhet të bëjnë angazhime serioze. Në fakt, duhet të jenë të vetëdijshëm se për shkak të specifikave të këtij rajoni, politikat duhet të jenë shumë të kujdesshme dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete dhe afatgjata. Veprimet që kanë efekte afatshkurtëra nuk mund të konsiderohet si zgjidhje adekuate.

Vëmendje të veçantë duhet kushtuar forcimit të sektorit privat, respektimit të të drejtave të njeriut dhe të pakicave, integritit të plotë të minoritetit shqiptar në institucionet shtetërore, zgjidhjeve më të mira për arsimim dhe të kujdesit shëndetësor në Luginën e Preshevës.

Në sferën ekonomike duhet të zhvillohen projekte dhe të shihet e zbatueshme mundësia e punësimit të punëtorëve të rinj. Ndërmarrjet e vogla për fat të keq nuk shihen si një zgjidhje e mundshme sepse ato mezi mund t'i mbijetojnë kushteve aktuale dhe konkurrencës.

Mbi të gjitha, rajoni i Luginës së Preshevës duhet të promovohet me qëllim të tërheqjes së investitorëve të huaj. Për të promovuar më mirë potencialet për zhvillim, tre komunat duhet të angazhohen me një marketing më të fuqishëm.

Lugina e Preshevës ka shumë potencial për zhvillim si në aspektin gjeografik, ashtu edhe në aspektin e burimeve natyrore dhe njerëzore. Gjithçka që nevojitet është: vullneti i fortë për të ndryshuar “status quo”-në aktuale, një vizion i mirë përpara, zhvillimi i strategjive adekuate, organizimi adekuat dhe reforma të përcjellura me një punë shumë të përkushtuar në drejtim të arritjes së një prosperiteti të qëndrueshëm dhe progresiv.

© DKE 2013

<http://www.southeast-europe.org>
Kontakt: dke@southeast-europe.org

*

Shënim: të respektuar kërkues noqëftëse bëni një referim të ky artikull ose përmendeni një pjesë të tij, ju lutemi në çoni një e-mail në adresën: dke@southeast-europe.org që të na bëni njoftim. *Ju lumi shënoni artikullin kështu:*

Fidan Kosumi: Sfidat ekonomike në Luginën e Preshevës. *International Relation Quaterly* (Dimër 2013) ff 1-4.
Faleminderit për mirëkuptimin. *Kryedaktori.*